




Përgjigju duke rrethuar shkronjën e vetëm një prej opsioneve të dhëna si përgjigje. Çdo përgjigje e saktë jep 2 pikë. Shkruaj me laps. Nuk jepen pikë nëse keni rrethuar dy ose më shumë përgjigje ose nëse e keni përshkruar përgjigjen.

TEST ME MË SHUMË SE NJË PËRGJIGJE PREJ TË CILËVE VETËM NJË ËSHTË E SAKTË
(Përgjigjuni duke rrethuar **vetëm një** prej opsioneve të dhëna nën A, B, C dhe D)

1. Struktura e dhënë më poshtë është e:



- A. α -D-glukopiranozës.
- B. β -D-glukopiranozës.
- C. β -D-glukofuranozës.
- D. α -D-galaktopiranoza.

2. Sa izomerë optik ka fruktoza?

- A. 6
- B. 8
- C. 12
- D. 16

3. Celobioza është produkt i dekompozimit të:

- A. amilozës.
- B. glikogjenit.
- C. amilopektinit.
- D. celulozës.

4. Gjatë hidrolizës së një sasi të caktuar të laktozës fitohet:


- A. po e njëjta sasi e glukozës dhe po e njëjta sasi e galaktozës.
- B. po e njëjta sasi e glukozës dhe po e njëjta sasi e fruktozës.
- C. sasi dy herë më e madhe e glukozës.
- D. sasi dy herë më e madhe e galaktozës.

5. Cili prej pohimeve në vijim është i saktë për glikogjenin?


- A. Molekula e glikogjenit është e ndërtuar ngjashëm si molekula e amilozës.
- B. Njësitë galaktopiranoze në strukturën e glikogjenit kanë lidhje $\alpha(1,4)$ glikozide.
- C. Glikogjeni është polimer i degëzuar i glukozës.
- D. Molekula e glikogjenit është e ndërtuar prej 8-12 njësive glukopiranoze.

6. Cili prej komponimeve në vijim mund të formon glikozide?


A.




B.



C.



D.



7. Cili prej pohimeve në vijim **NUK ËSHTË** i saktë për acidin linoleik?

- A. Është acid i lartë yndyror thelbësor.
- B. Ka 18 atome C në molekulë.
- C. Acid yndyror poli i pangopur.
- D. Emri sistematik është acid okta-9,14-dienik.

8. Me emrin vitamin B₆ përfshihen:

- A. retinoli dhe retinali.
- B. holekalciferol, ergokalciferol dhe dihidroergokalciferoli.
- C. tokol dhe tokoferol.
- D. piridoksol, piridoksal dhe piridoksamin.

9. Cili prej komponimeve në vijim **NUK KA** strukturë steriode?

- A. Vitamina D.
- B. Acidi i tëmthit.
- C. Vitamina A.
- D. Hormonet kortikoide.



Përgjigju duke rrethuar shkronjën e vetëm një prej opsioneve të dhëna si përgjigje. Çdo përgjigje e saktë jep 2 pikë. Shkruaj me laps. Nuk jepen pikë nëse keni rrethuar dy ose më shumë përgjigje ose nëse e keni përshkruar përgjigjen.

10. Histonet bëjnë pjesë në grupën e:


- A. Sferoproteineve.
- B. Kromoproteineve.
- C. Skleroproteineve.
- D. Fosfoproteineve.

11. Tretshëmria e proteinave globulare në ujë mund të rritet me:


- A. Shtim të klorurit të natriumit.
- B. Rritjen e temperaturës në 35°C .
- C. Shtim të acetonit.
- D. Rritje të temperaturës në 65°C .

12. Cila prej aminoacideve në vijim nuk tregon aktivitet optik?


A.




B.



C.



D.



13. Cila prej çifteve të dhëna më poshtë mund të jetë e mundshme në ADN-në, si rezultat i formimit të lidhjes hidrogjenore?

- A. T-A
- B. G-A
- C. G-T
- D. A-C

14. Gjatë hidrolizës së plotë të adozin dyfosfatit fitohet:

- A. adozin, ribozë dhe sasi e dyfishtë e acidit fosforik.
- B. adozin, ribozë dhe po aq sasi e acidit fosforik.
- C. adenin, ribozë dhe sasi e dyfishtë e acidit fosforik.
- D. adenin, ribozë dhe po aq sasi e acidit fosforik.

15. Në natyrë magnezi ka tri izotope, ^{24}Mg (79 %), ^{25}Mg (10 %) ^{26}Mg (11 %). Llogarit masën atomike relative të magnezit.

- A. 24,32
- B. 24,53
- C. 24,00
- D. 24,78

16. Në shtresën e fundit elektronike të atomit të elementit Z ka 5 elektrone. Gjatë reaksionit me Na do të fitohet:

- A. Na_3Z
- B. NaZ_3
- C. Na_5Z
- D. NaZ_5

17. Sa është ngarkesa e jonit të ndonjë elementi X, i cili ka 7 protone, 6 neutrone dhe 10 elektrone?

- A. 4-
- B. 3+
- C. 3-
- D. 4+

18. Cili është numri maksimal i elektroneve në një atom, për të cilin: $n = 5$, $m_l = +1$?

- A. 2
- B. 4
- C. 8
- D. 10

19. Cili prej joneve në vijim ka konfiguracion elektronik të gazi inert? (^{25}Mn , ^{26}Fe)

- A. Mn^{2+}
- B. Mn^{7+}
- C. Fe^{2+}
- D. Fe^{3+}

20. Elektronegativiteti i hidrogjenit është rreth 2,2. Sipas kësaj, në komponime të caktuara përveç karakterit kovalent ka edhe shkallë të caktuar të karakterit jonik. Cili prej opsioneve në vijim do të ketë karakter jonik më të theksuar?

- A. H-F
- B. H-I
- C. H-Br
- D. H-Cl



Përgjigju duke rrethuar shkronjën e vetëm një prej opsioneve të dhëna si përgjigje. Çdo përgjigje e saktë jep 2 pikë. Shkruaj me laps. Nuk jepen pikë nëse keni rrethuar dy ose më shumë përgjigje ose nëse e keni përshkruar përgjigjen.

21. Izotopi i një elementi të panjohur X ka numër të masës 79. Joni më stabil ka 36 elektrone. Elementi X me natriumin formon komponim binar me formulë kimike Na_2X . Cili prej pohimeve në vijim është i saktë?

- A. Komponimi binar që do të formohet në mes të X dhe fluorit do të jetë komponim kovalent.
- B. Komponimi binar që do të formohet në mes të elementit X dhe fluorit do të jetë komponim jonik.
- C. Izotopi i elementit X ka 38 protone.
- D. Izotopi i elementit X ka 41 neutrone.

22. Konfiguracioni elektronik i shtresës së fundit të elementit më elektronegativ është:

- A. $2s^2 2p^5$
- B. $3s^2 3p^5$
- C. $4s^2 4p^5$
- D. $5s^2 5p^5$

23. Renditi elementet sipas rritjes së energjisë së jonizimit.

- A. $\text{Sb} < \text{As} < \text{Cl} < \text{P}$
- B. $\text{Sb} < \text{As} < \text{P} < \text{Cl}$
- C. $\text{As} < \text{Cl} < \text{P} < \text{Sb}$
- D. $\text{Cl} < \text{Sb} < \text{P} < \text{As}$

24. Mendohet se vendi më i përshtatshëm i hidrogjenit në sistemin periodik është në grupën e parë, dhe kjo kryesisht meqë:

- A. Hidrogjeni, ashtu si edhe elementet tjera në këtë grupe është elektronegativ, si dhe ka konfiguracion elektronik të shtresës së fundit të ngjashme me elementet e grupës së parë.
- B. Hidrogjeni, ashtu si edhe elementet tjera në këtë grupe është elektropozitiv, si dhe ka konfiguracion elektronik të shtresës së fundit të ngjashme me elementet e grupës së parë.
- C. Hidrogjeni ashtu si edhe elementet tjera të grupit të parë formon vetëm komponime jonike.
- D. Hidrogjeni ashtu si edhe elementet tjera të grupit të parë formon vetëm komponime kovalente.

25. Cili prej pohimeve është i saktë?

- A. Të gjitha elementet p janë jometale.
- B. Elementet e grupit të 17-të quhen halkogjene.
- C. Tek elementet p tërësisht janë të plotësuara orbitalet ns .
- D. Të gjithë opsionet e lartpërmendura

**КЛУЧ ЗА ОПШТИНСКИ НАТПРЕВАР ПО ХЕМИЈА ЗА СРЕДНО ОБРАЗОВАНИЕ
2020**

IV КАТЕГОРИЈА

1	D
2	B
3	D
4	A
5	C
6	B
7	D
8	D
9	C
10	A
11	B
12	C
13	A
14	C
15	A
16	A
17	C
18	C
19	B
20	A
21	A
22	A
23	B
24	B
25	C